

PJESA KONTRATA

Date: 11.09.2020.

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

N.N.SH "REAL" – Dragash -Operatori Ekonomik", ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Sanimi i kulmit të objektit të zjarrfiksave dhe shpetimit në Dragash me numër Identifikues **621-20-4394-2-3-6**, dhe nr, te mbrendshem **621-2020-099-236**.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Sanimi i kulmit të objektit të zjarrfiksave dhe shpetimit në Dragash**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **14.09.2020**, dhe përfundon me **14.10.2020**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **3 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [ekzekutimit të punëve]do të jetë **Qendra e zjarrfiksave ne Dragash**

1.5 **Menagjer i kontrates nga AK eshte:Damir Haljili**

Menagjer i projektit nga AK eshte: Florim Krasniqi

Menagjer i projektit nga OE eshte: Arben Mazreku

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë **6,660.48 €**; (*gjashtë mij e gjashtëqind e gjashtedhjetë Euro e katerdhjet e tete cent*).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë punimeve, me anë të procesverbalit të pranimit nga ana e komisionit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale



të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore



13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatën Themelore në Prizren, dega në Dragash* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik		Për Autoritetin Kontraktues	
Emri:	N.N.SH “ REAL“ – Dragash	Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	menagjeri	Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.09.2020.	Data:	11.09.2020.
Vula:		Vula:	



¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Kërkimi sh. 2 sh

Real

PARAMASA E PROJEKTIT: Sanimi i kulmit te objektit te zjarrfiksave dhe shpetimit në Dragash**A****PUNËT PËRGATITORE**

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Punëmarrësi është i detyruar që para fillimit të punimeve të bëjë rrethimin e punishtës, t'i montojë barakat montazhe (kontejnerët) për materiale dhe punëtorë. Pas përfundimit të punimeve të njëjtat duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit dhe terrenit rreth objektit në tërësi.	komplet	1	50.00	50.00 €
2	Furnizimi me ambalazh mbrojtës dhe paketimi me kujdes i gjesendeve me vlerë në zonë ku do të rinovohet, duke përfshirë bartjen dhe lëvizjen e mobiljeve ekzistuese duke u kujdesur që mos lëndohen dhe kthehen në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Mobiliat si dhe gjerat me vlerë të ambalazhuara gjatë kryerjes së punimeve duhet të depozitohen (Magazinohen) në zonë të sigurtë. Vërejtje: Çdo dëmtim evetual të gjerave me vlerë të orendive gjatë zhvendosjes/lëvizjes nga pakujdesia e punëtorve mbetet përgjegjësi e Operatorit Ekonomik që ta kompenzojë dëmin.	komplet	1	100.00	100.00 €
Gjithsej punët pregatitore:					150.00 €

B**PUNËT E DEMOLIMIT**

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
Punëmarrësi është i detyruar që të gjitha materialet e demoluara (sipas pos. te poshtëshënuara) t'i largojë nga punishtja apo t'i transportojë deri në deponinë e caktuar për deponim materiale. Materialet që i nevojiten Autoritetit Kontraktues duhet të deponohen në depot e parapara për grumbullim të materialit në depot e Komunës.					
1	Demolimi dhe largimi i kujdeshem i rrufepritesit nga kulmi. Materiali i demeluar ruhet me kujdes me qëllim të ri-përdorimit në deponi e përcaktuar nga organi mbikqyrës duke përfshirë edhe transportin deri në 15 km largësi. Llogaritur në komplet	komplet	1.00	50.00 €	50.00 €

2	Demolimi dhe largimi i kujdesëshem i mbulesës së kulmit nga pllakat e sallonit. Materiali i demoluar ruhet me kujdes me qëllim të ri-përdorimit në depon e përcaktuar nga organi mbikqyrë duke përfshirë edhe transportin deri në 15 km largësi. Llog në m2 largësi, ndërsa mbeturinat e pa përdorshme do të asgjësohen në deponin më të afërt të qytetit . Llogaritja e demolimit të pllakave sallonit me dimensione 105x122 cm. Në këtë pozicion përfshihet edhe largimi i ulluqeve Listellave.	m ²	274.70	0.50 €	137.35 €
Gjithsej punët e demolimit					187.35 €

C	PUNËT E KULMIT				
1	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi e përforcimi i dërrasave me trashësi d=2.0 cm të përforcuar në kulm të pjerrtë. Llogaritja me të gjitha shpenzimet duke përfshirë mjetet e punës si dhe fuqinë punëtore, materialin për gozhdim të shprehura në m2 për sipërfaqe të kulmit të pjerrtë.	m2	276.75	2.20 €	608.85 €
2	Furnizimi, transportimi, punimi dhe vendosja e një shtrese membranës mbuluese është mbrojtja nga rrjedhja e mundshme e kulmit. Membrana vendoset në drrasat nga drurit të parapregaditura me parë . Izolimi punohet përmes shtrirjes së rollës së materialit në drjtim të ramjes së pjerrtësis me një palim prej 10 cm me rendin paraardhës.Llog në m2 për sipërfaqe të kulmit të pjerrtë.	m2	276.75	0.50 €	138.38 €
Gjithsej punët e kulmit dhe mbulesës:					747.23 €

D	PUNËT E MBULESËS DHE LLAMARINËS
----------	--

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i mbulesës së konstruksionit të kulmit nga llamarina e plastifikuar e brinjëzuar. Në çmim të llogariten edhe kulmaret e nevojshëm për mbulimin e thyerjeve të rrafshëve të sipërfaqeve të kulmit si dhe instalimi i rrufepritesit dizajnin dhe ngjyren e perzgjesdh investitori. Llog në m2 të sipërfaqes së projekcionit të pjerret.	m ²	276.75	5.50 €	1,522.13
2	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i ullukut horizontal nga llamarina e plastifikuar me dim 14/14 cm d=0.55 mm sipas detalit konstruktiv. Llog në m'	m'	27.00	5.00 €	135.00
3	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i ullukut vertikal me dim 12/12 cm, nga llamarina e plastifikuar d= 0.55 mm sipas detalit konstruktiv. Llog në m'	m'	42.60	4.00 €	170.40
4	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i mveshjes të kallkoneve nga llamarina e plastifikuar d= 0.55 mm sipas detalit konstruktiv. Detali të realizohet sipas zgjidhjes arkitektonike. Llog në m'.	m'	41.00	4.50 €	184.50
Gjithsej punët e mbulesës dhe llamarinës:					2,012.03

E	PUNËT E KERAMIKËS DHE TAVANEVE
----------	---------------------------------------

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizimi me material dhe punimi i konstruksioneve të tavaneve të objektit, sipas përshkrimeve në detaje grafike . Në çmim të llogaritet edhe stiropori i presuar N4 me trashësi prej 8cm si dhe PVC-folia dhe suvatimi me një rrjetë rabi. Tavani i varur me elemente nga knaufi ,deri në finalizim.Llog në m2	m ²	83.60	14.50 €	1,212.20 €
2	Furnizimi me material dhe punimi i mveshjes të tavaneve të garazhit ,me llamperi sipas përshkrimeve në detaje grafike . Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosje baz dhe dy shtresa me sadolin ngjyr ,deri në finalizim.Llog në m2	m2	113.28	6.00 €	679.68 €
3	Furnizimi me material dhe punimi i mveshjes të strehëve dhe kallkoneve të objektit ,me llamperi sipas përshkrimeve në detaje grafike . Në çmim të llogaritet edhe ngjyrosje baz dhe dy shtresa me sadolin ngjyr ,deri në finalizim.Llog në m2	m2	68.00	6.00 €	408.00 €

4	Punimi i mureve të kthines se korridoreve te tualeteve dhe garazhes me pllaka keramike ne naltesi h=1,0 m te klasit pare. Në çmim është përfshirë edhe punimi i cokllës në vijë-takimet e mureve perimetrike. Punimi të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit. Disajnimi dhe ngjyren e zgjedh Investitori.Llog.ne m2.	m ²	46.40	15.00 €	696.00 €
Gjithsej punët e keramikës dhe tavaneve:					2,995.88 €

F	PUNËT E ZDRUKHTARIS
---	---------------------

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
	Para furnizimit , paraprakishtë duhet kontrollohen të gjitha masat ndërtimore te dyerve dhe dritarëve nga brenda dhe jashtë . Në çmim përfshihet të gjitha punët e muratimit(suvatimit) dhe në mbushjen e vrimave dhe finalizimin e vendosjes së tyre.				
1	Furnizimi si dhe punimi i PVC zdruckhtaris se dyerve të mbrendeshme dhe te jashtme me min 8 cm profil me min 6 komora dhe tre digtuma gome,dhe shtangim nga profili metalik min 2 mm,dy fisht e mbushur me gaz argon ,gjami (4+16+4) mm,Vinkhaus ose roto mekanizem.Dyert duhet te jenë shtanguara me elemente metali te fiksuara.Dyert duhet te kene mekanizma te cilit mundesojn hapje normalishte. dhe ate sipas standardeve.Dera duhet te kete brave me cilinder dhe tre celsa.Të gjitha të punohen sipas skemave te zdruckhtaris.Ne cmim parashifet edhe demolimi i dyerve egzistuese te cilat duhet te zavesohen				
	Derë e mbrendeshme me dim 70/210 cm	cope	2	134.00 €	268.00 €
	Derë e mbrendeshme me dim 100/210 cm	cope	1	140.00 €	140.00 €

2	Furnizimi si dhe punimi i PVC zdrukthtaris se Dritareve me min 8 cm profil me min 6 komora dhe tre digtuma gome,dhe shtangim nga profili metalik min 2 mm,dy fisht e mbushur me gaz argon ,gjami (4+16+4) mm,Vinkhaus ose roto mekanizem.Dritaret duhet te jenë shtanguara me elemente metali te fiksuara.Dritaret duhet te kene mekanizma te cilit mundesojn hapje normalishte. dhe ate sipas standardeve.Dritarja duhet të punohen sipas skemave te prezentuara.Në çmim përfshihet të gjitha punët e muratimit(suvatimit) dhe në mbushjen e vrimave dhe finalizimin e vendosjes së tyre.Ne cmim parashifet edhe demolimi i dritareve egzistuese te cilat duhet te zavedesohen.				€
	Dimensionit 80/90 cm	cope	2	80.00 €	160.00 €
	Gjithsej punët e zdrukthtaris:			80.00 €	568.00 €

RE KAPITULIM I P UNIMEVE

A	PUNËT PËRGATITORE	150.00 €
B	PUNËT E DEMOLIMIT	187.35 €
C	PUNËT E KULMIT	747.23 €
D	PUNËT E MBULESËS DHE LLAMARINËS	2,012.03 €
E	PUNËT E KERAMIKËS DHE TAVANEVE	2,995.88 €
F	PUNËT E ZDRUKHTARIS	568.00 €
GJITHSEJ PUNËT NDËRTIMORE ME TVSH		6,660.48 €